



Zyra Qendrore, Rr. Xh. Bush #26, 10000 Prishtinë, Kosovë

FTESË PËR OFERTË

Ref no: T-0002-01-2026 ProCredit Bank

Banka ProCredit fton të gjitha kompanitë e interesuara të paraqesin ofertat e tyre për:

T-0002-01-2026 Vlerësimi i riskut në vendin e punës dhe shqyrtimi i rezistencës së sistemit të tokëzimit dhe rrufepritësve në objektet e bankës ProCredit

Të interesuarit mund t'i kërkojnë dokumentet për aplikim nga data **04/02/2026** deri më datë **13/02/2026** në e-mail adresën kos.Procurement@procredit-group.com.

Vërejtje:

- ProCredit Bank është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e ofruara nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet që ta listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së, ndërsa ofertuesit që nuk janë deklarues të TVSH-së (bëjnë shitje të përjashtuar nga TVSH-ja), nuk duhet të listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së.
- Për çmimet të cilat nuk e kanë të listuar TVSH-në ndarazi, do të nënkuptohet se vlera e TVSH-së është e përfshirë brenda çmimit.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë katër muaj (120 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Çmimet kuotohen në Euro (€).
- ProCredit Bank mban të drejtën të kërkojë informata shtesë nga kompanitë e kualifikuara për ofertim.
- Kompania e përzgjedhur duhet të jetë e gatshme të ofrojë shërbimet në momentin që kërkohet nga ProCredit Bank,
- ProCredit Bank ka të drejtë të anulojë tenderin dhe/ose ndryshojë karakteristikat e tenderit dhe ti ftojë pjesëmarrësit për të sjellur sërish ofertat e tyre.
- ProCredit Bank ka të drejtë të zgjedh një apo më shumë fitues për këtë proces prokurimi, apo të ketë marrëveshje me më shumë se një kompani për të njëjtat shërbime/furnizime të cilat janë të parapara në këtë ftesë për ofertë.

Data e fundit për dorëzimin e ofertës së kompletuar në bankë është **13/02/2026, ora 14:00**.

Oferta duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur dhe e shënuar qartë **T-0002-01-2026 Vlerësimi i riskut në vendin e punës dhe shqyrtimi i rezistencës së sistemit të tokëzimit dhe rrufepritësve në objektet e bankës ProCredit** në Zyrën Qendrore të Bankës ProCredit (Rr. Xhorxh Bush Nr. 26, 10000 Prishtinë).

Çdo pyetje shtesë rreth kësaj ftese për ofertë mund ta adresoni në:
kos.procurement@procredit-group.com